

VENDIM
Nr. 109, datë 26.10.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË NDIHMËS
SHTETËRORE NR. 103, DATË 19.7.2021, “AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE ‘PËR FUQIZIMIN E GRAVE DHE NXITJA E SIPËRMARRJES’”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Znj. Delina Ibrahimaj	kryetare;
Znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
Znj. Inida Methoxha	anëtare;
Znj. Brikena Qela	anëtare;
Z. Ahmet Mançellari	anëtar,

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 26.10.2022, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 22.8.2022, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Tiranë, me shkresën nr. 29599, datë 27.6.2022, për zbatimin e projektit “Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes” për vitin 2023;

Bashkia e Tiranës referon se në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 166, datë 24.12.2021, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022–2024, në programin Kujdesi Social dhe Solidariteti,

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 17, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 4, të kreut II, “Përshkrimi i masës”, të vendimit të KNSH nr. 103, datë 19.7.2021, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes’”, në:
“Kohëzgjatja: Plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2023–2024.”.

2. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Delina Ibrahimaj